

**NË EMËR TË POPULLIT**  
**P.nr.2369/17**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm**, me gjyqtarene vetme gjykuese Albina Shabani Rama, me procesmbajtësen Ganimete Dumani, në çështjen penale kundër të pandehurit B.M., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2428/16, të dt. 22.05.2017, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.18.05.2018, në praninë e prokurorit të shtetit Musa Mehaj, të pandehurit B.M., të dëmtuarit V.R., në bazë të nenit 366 të KPP të Republikës së Kosovës, të njëjtën ditë mori dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurin: B.M.**, nga i ati O. dhe ëma Xh., e gjinisë K., i lindur me datë ... në P., tani me vendbanim në B., Komuna e P., ka të kryer shkollën e mesme, i pa papunë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**S e p s e:**

Me datën 28.04.2016 rreth orës 16.30, në rrugën “N.G.” në P., drejtim për G., në afërsi të “V.F.”- it, i pandehuri B.M., nga pakujdesia, e në kundërshtim me nenin 41 të LSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve dhe pasurisë në komunikacionin rrugor, në atë mënyrë, me veturën e tij të tipit “MercedeDaimlerChrysler” ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., ka marrë veprimin e tejkalimit të automjetit që kishte qenë para tij, ku me këndin e përparme të djathtë të automjetit e godet në anën e përparme të majtë automjetin e të dëmtuarit V.R. e tipit “MercedesBenz”, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., ashtu që i pandehuri vazhdon të lëviz me automjetin e tij në të majtë dhe godet në anën e majtë automjetin e tipit “FordFocus”, ngjyrë të zezë, me targat e regjistrimit ... që gjendej i parkuar në anën e majtë në trotuar jashtë rrugës, me ç rast në bazë të Ekspertizës mjeko-ligjore nga Dr.M.G. dhe Dr. D.H., dt.19.04.2017, lëndime të lehta trupore, ka pësuar E.B., si dhe janë shkaktuar dëme materiale në automjete,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 41; 43; 46; 73; 75 dhe 76 pika 1.7 të KPRK-së dhe neneve 248; 359 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

**D Ë N I M M E G J O B Ë**

Në shumë prej **250 (dyqindpesëdhjetë) €**, me mundësi pagese në 3(tri) këste mujore, të cilin dënim do të filloj ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumën prej **40.88€** dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **20.00 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **30.00 €**, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar ka hek dorë nga kërkesa pasurore juridike.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.2428/16, të dt. 22/05/2017, ka akuzuar B.M., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë.

Gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe me dt. 10.10.2017 ka nxjerr urdhrë ndëshkimor ndaj të pandehurit, i pandehuri në afatin ligjor e ka kundërshtuar urdhrin ndëshkimor të lëshuar nga gjykata.

Gjykata me dt. 18.05.2018 ka caktuar dhe e ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, gjatë secilës seancë u dëgjuan prokurori i shtetit Ibrahim Fejza, i dëmtuari V.R.dhe i pandehuri B.M..

Fillimisht i njëjti nuk e pranoi fajësinë për veprën penale e cila iu vu në barrë, me këtë rast gjykata vazhdoi me fjalën hyrëse të palëve si dhe me dëgjimin e të dëmtuarit- dëshmitari.

I dëmtuari- dëshmitari V.R. deklaroi se atë ditë ka qenë duke lëvizur në rrugën në drejtim të G., më saktësisht ka dashur të ndalet te “V.F.”, në momentin që ka dashur të ndalet dhe te kthehet ka ndezur sinjalizuesin në të majtë, ka shikuar retrovizoren dhe në momentin kur ka marrë veprimin për tu kthyer, papritmas me një shpejtësi të madhe është goditur nga automjeti i tipit “Mercedes”. Në atë moment ai ka qenë në shiritin tjetër, sepse sapo kishte filluar kthimin në të majtë, dhe nga fuqia goditësi i njëjti është sill dhe ka lëvizur nga vendi.

Gjykata ka vazhduar me administrimin e provave materiale ekspertizën e komunikacionit të dt. 04.03.2017 të punuar nga eksperti A.K., konstatimet e mjekut ligjor të dt. 19.04.2017 lidhur me llojin dhe natyrën e lëndimeve për të dëmtuarën E.B., si dhe foto dokumentacioni i vendi të ngjarjes.

Pas përfundimit të procedurës së provave, i pandehuri në këtë fazë të procedurës deklaroi se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga prokuroria.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet dhe pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, në bazë të nenit 326 të KPP gjykata përshtatshmërisht zbatoi dispozitat e nenit 248 par 4 dhe me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte e vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, gjykata në bazë të nenit 326 par.4 të KPPK-së, ka kaluar në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Ibrahim Fejza, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë, i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit ndërsa pranimin e fajësisë ta marrë si rrethanëlehtësuese.

I dëmtuari V.R. në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit. I njëjti nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike pasi që është kompensuar nga kompania e sigurimeve.

I pandehuri B.M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkoj nga gjykata që pranimin e fajësisë dhe kushtet e tij ekonomike ti marrë parasysh me rastin e shqiptimit të dënimit dhe të njëjtit ti mundësojë që dënimin em gjobë ta paguaj me pagesën me këste, si dhe i njëjti deklaroi se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin duke premtuar se nuk do ta përsërisë më.

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, por edhe nga deklaramet e palëve në procedurë si dhe nga vet pranimi i fajësisë nga i pandehuri, po ashtu edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit B.M., formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si në hyrje të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese se: i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqiptoj dënim me gjobë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, me bindje se kjo është e mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par. 2 KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryerësit, si dhe do të ndikoj të mos kryej vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pikat 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.2369/17, i dt.14.06.2018**

Procesmbajtësja,  
Ganimete Dumani

Gjyqtarja,

Albina Shabani Rama

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë